

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies
au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Procesverbal i Seancës Plenare me 4 dhjetor 2003

Seanca Plenare

Seanca nr.2003/31

Prishtinë, më 4 dhjetor 2003 në ora 10,00

Ndërtesa e Kuvendit Komunal të Prishtinës

PROCESVERBAL

Nga Seanca plenare e Kuvendit të Kosovës, mbajtur më 4 dhjetor 2003, më fillim në ora 10,00.

Seancën e kryesoi **Nexhat Daci**, kryetar i Kuvendit, kurse bashkëryesues ishin, në pjesën e parë **Oliver Ivanoviq**, kurse në pjesën e dytë **Bajram Kosumi**, anëtarë të Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 95 deputet dhe deklaroi të hapur punën e saj.

Seancës plenare iu propozua rendi i ditës i miratuar në seancën e mëparshme, si vijon:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme ;
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kadastër (2003/30);
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për produktet medicinale dhe pajisjet medicinale(2003/17);
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Buxhetin vjetor të konsoliduar të Kosovës dhe përvetsimet për periudhën 1 janar deri me 31 dhjetor 2004 (2003/34);
5. Njohtimi me mendimin e Komisionit për Gjyqësi, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese lidhur me mocionin e deputetit Ismail Kurteshi;
6. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare për 11 dhjetor 2003:

Kryetari propozoi që të procedohet sipas rendit të ditës, të miratuar në seancën e fundit.

Arsim Bajrami, në emër të Grupit parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, tha se duke marrë parasysh zhvillimet e fundit në Trupat propozoj që Kuvendi në seancën e ardhshme të hapë debatin për gjendjen në Trupat e Mbrojtjes së Kosovës dhe të ftohet edhe komandanti i TMK-së, gjeneral lejtant Agim Çeku, që të raportoj.

Bujar Dugolli, në emër të Grupit parlamentar të Aleancës për ardhmerinë e Kosovës, mbështeti propozimin e z. Bajrami, duke propozuar që në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të rradhitet Shqyrtimi i gjendjes në Trupat mbrojtëse të Kosovës.

Dragisha Krstoviq, në emër të Grupit parlamentar "Kthimi", kundërshtoi këtë propozim me arsyetim se këto çështje nuk janë në kompetencë të Kuvendit, por nëse ndodhë, atëherë duhet të ftohet z. Hollkeri.

Kryetari e përmbylli këtë debat duke konkluduar se Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e rregulltë, do t'a shqyrton këtë propozim dhe do të marrë qendrim të caktuar.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Rangjel Nojkiq, theksoi se në këtë procesverbal nuk kanë hyrë vrejtitet që ai i ka bërë në seancën e kaluar. Njëherit kërkoj që emërtimi i Kosovës të shkruhet ashtu siqë ai e shqipton.

Kryetari e përblylli këtë pikë duke konkluduar se çdo emërtim tjetër që nuk përkon me emrin zyrtar të Kosovës, a të Kuvendit të Kosovës, kushdo që ta bëjë - nuk do të hyjë në dokumente zyrtare të Kuvendit.

2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kadastrën (2003/30)

Kryetari, në fillim dha këto konstatime hyrëse:

Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji për kadastrin ka bazueshmërinë juridike në Kornizën kushtetuese të Kosovës.

Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve ka vlerësuar se Projektligji për kadastrin dhe amendamentet e propozuara nuk i cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Komisioni për buxhet ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për kadastrin dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Amendamentet e propozuara në mënyrë specifike reflektojnë qëndrimet e komisioneve parlamentare dhe të deputetes Nekibe Kelmendi.

Nekibe Kelmendi, në emër të kryesuesës të Komisionit për Shërbime publike, në pajtim me rregullën 33.3 të Rregullorës së përkohshme të punës së Kuvendit, dha arsyetimin në mbështetje

të Raportit të këtij Komisioni lidhur më amendamentet e rekomanduara në Projektligjin për kadastër.

Në vazhdim, kryetari procedoi duke i hudh në votim amendamentet veç e veç të deputetës **Nekibe Kelmendi** me përkrahje të Komisionit për shërbime publike si komision funksional dhe tëdhe të Komisionit për bujqësi,pylltari dhe zhvillim rural.

Kuvendi me shumicë votash , i miratoi këto amendamente:

2,3,4,5,7,8,10,11,12,13,14,15,16,17,18,21,22,23,24,26,27,28,29,30,31,32,dhe 33 /teksti standard/
ndërsa **nuk miratoi** këto amendamente: 1,6,9,19,20, dhe 25,

Pas konstatoi se në sallë ishin të pranishëm 100 deputet, kryetari e hodhi në votim takstin e Ligjit për kadastër, në terësi dhe rezultati ishte si vijon:

Për	Shumica,
Kundër	20	
Abstenim	7	

Kryetari konstatoi se Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash e miratoi Ligjin për kadastër .

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për produktet dhe pajisjet medicinale (2003/17)

Kryetari, në fillim të procedimit dha këto konstatime hyrëse:

Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji për produktet medicinale dhe pajisjet medicinale ka bazueshmërinë juridike në Kornizën kushtetuese të Kosovës.

Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve ka vlerësuar se Projektligji për produktet medicinale dhe pajisjet medicinale, me amendamentet e propozuara nuk i cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Komisioni për buxhet ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit, me amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore, përveç amendamentit 39.

Amendamentet e propozuara, në mënyrë specifike reflektojnë qëndrimin e Komisionit funksional si Komision raportues.

Haki Shatri, sqaroi deputetëve se Komisioni për buxhet amendamentet e Komisionit funksional i ka shqyrtuar me datën 1 dhjetor dhe ka vendosur që të përkrah edhe amendamentin 39.

Në vazhdim **kryetari**, propozoi si vijon:

“Në pajtim me Rregullën 34, pika 2 e Rregullores së përkohshme të punës të Kuvendit, për arsye të ndërlidhjes së disa amendamenteve mesveti dhe mundësisë që t’i nënshtrohet një votimi të vetëm, atëherë propozohet miratimi në grup – paket i amendamenteve në Projektligjin për produkte dhe pajisje medicinale, të cilët janë të natyrës teknike apo gjuhësore, e që janë gjithsej 35 amendamente dhe atë: amendamenti 4, 11, 12, 15, 17, 20, 26, 29, 36, 38, 43, 47, 48, 50, 51, 52, 54, 55, 60, 62, 64, 67, 68, 72, 75, 76, 77, 85, 86, 87, 88, 92, 93, 95 dhe 103. “

Propozimi u dha në votim dhe rezultati ishte :

Për Shumica,
Kundër 10
Abstenim ... 1

Kryetari konstatoi se me shumicë votash, në pako u miratuan amendamentet e lartpërmendura.

Pastaj u kalua në procedimin e votimit të amendamenteve tjera përmbajtësore dhe deputetët me shumicë votash **aprovuan** këto amendamente : 1,2,3,5,6,7,8,9,10,13,14,16,18,19,21,22,23,24,25, 27,28,30,31,32,33,34,35,37,39,40,41,42,44,45,46,49,53,56,57, 58/të fshihet neni 8.3/,61,63,65, 66,69,70,71,73,74,78,79,80,81,82,83, 83a /sipas propozimit të deputetës Teuta Hadri, shtohet neni 16.10/,84,89,90,91,94,96,97,98,99,100,101,102,104,105 dhe 106.

Pas konstatoi se në sallë ishin të pranishëm 99 deputet, kryetari e hodhi në votim takstin e Ligjit për produktet dhe pajisjet medicinale , në terësi dhe rezultati ishte si vijon:

Për Shumica,
Kundër 15
Abstenim 2

Kryetari konstatoi se Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash e miratoi Ligjin për produktet dhe pajisjet medicinale.

Pasoi pauza prej 30 minutave.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Buxhetin vjetor të konsoliduar të Kosovës dhe përvetsimet për periudhën 1 janar deri me 31 dhjetor 2004 (2003/34);

Konstatimet hyrëse të Kryetarit:

Debati i sotëm mund t’iu shërbejë qëllimeve të përgjithshme dhe vetëm parimore.

Vërejtjet parimore do t’i referohen pastaj shqyrtimit të komisioneve kryesore dhe funksionale.

Prezentimin e Ligjit, në emër të Qeverisë, e bëri ministri i financave dhe ekonomisë, zoti **Ali Sadria**.

Ekspozeu përmbajtësor i ministrit Sadria, sipas tekstit në transkript është pjesë përberëse e procesverbalit nga kjo séancë.

Pas prezantimit të Projektligjit, kryetari hapi debatin në të cilin moren pjesë: **Haki Shatri**, në emër të LDK, **Arsim Bajrami**, në emër të PDK, **Bajram Kosumi**, në emër të AAK, i cili pastaj mori rolin e kryesuesit të séances plenare, **Xhezair Murati**, **Mahir Jagxhillar**, **Hydajet Hyseni**, **Muhamet Kelmendi**, **Fatmir Rexhepi**, **Ramadan Kelmendi**, **Flora Brovina**, **Sebahate Grajqevci**, **Nekibe Kelmendi**, **Smajl Latifi**, **Melihate Tërmkollli**, **Lirak Çelaj**, **Hasan Meta**, **Mehdi Bardhi** dhe **Sabri Hamiti**. Diskutimet e deputetëve si ne transkript te kësaj seance, janë pjesë përberse e këtij procesverbali.

Pas konstatoi se në sallë ishin të pranishëm 84 deputet, **kryesuesi** e hodhi në votim në parim takstin e Projektligjit për Buxhetin vjetor të konsoliduar të Kosovës dhe përvetsimet për periudhën 1 janar deri me 31 dhjetor 2004 (2003/34) dhe rezultati ishte si vijon:

Për Shumica,
Kundër asnjë
Abstenim 13

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash e miratoi në parim Projektligjin për Buxhetin vjetor të konsoliduar të Kosovës dhe përvetsimet për periudhën 1 janar deri me 31 dhjetor 2004 (2003/34).

Pastaj **Kryesuesi** i informoi deputetët se Komisioni për buxhet, Komisioni për gjyqësi, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, Komisioni për ekonomi dhe financa dhe Komisioni për komunitete e kanë obligim parësor shqyrtimin e Projektligjit në afatin e caktuar. Po ashtu ai ftoi Ministrinë për Financa dhe Ekonomi dhe ministrin që të bashkëpunojnë me komisionet në mënyrë që në këtë fazë të përgatitet për shqyrtim të dytë Projektligji në fjalë.

5. Njohtimi me mendimin e Komisionit për Gjyqësi, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese lidhur me mocionin e deputetit Ismail Kurteshi

Kryesuesi i njohtoi deputetët së konformë rregullës 27 pika 8 të Rregullorës së punës së Kuvendit, Komisioni për gjyqësi, legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese, i ka paraqitur Kuvendit mendimin lidhur me mocionin e deputetit Ismajl Kurteshi. Njëherit ai theksoi se mendimi i Komisionit iu është shpërndarë të gjithë deputetëve.

Ismajl Kurteshi, në diskutimin e tij shprehu pakënaqësinë lidhur me vlerësimin dhe mendimin e komisionit.

6. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare për 11 dhjetor 2003

Kryesuesi, në emër të Kryesisë propozoi rendin e ditës për seancën plenare me 11 dhjetor 2003, si vijon:

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Odën Ekonomike të Kosovës (2003/33).

Kryesuesi njëherit theksoi se Kryesia do t'i shqyrtojë edhe dy propozime që janë bërë, një në Kryesi e një këtu – debati për TMK dhe debati për operacionalizimin e standardeve, por për këto do të vendosë Kryesia në mbledhjen e ardhshme.

Kryesuesi deklaroi të mbyllur këtë seancë në orën 15,00.

Sekretaria e Kuvendit

Kryetari i Kuvendit,

akademik Nexhat Daci